

## RITET E DASMËS QË NDËRLIDHEN ME DHËNDËRIN

Rini USEINI<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians, University "Ss. Cyril and Methodius" - Skopje

\*Corresponding author e-mail: riniuseini@yahoo.com

### Përmbledhje

Ritualet janë pjesë e rëndësishme në jetën e njeriut. Në të kaluarën nëpërmjet ritualeve njerëzit janë munduar që mënyrë simbolike t'i përfitojnë të mirat dhe të ju largohen të këqijave ose më saktë nëpërmjet të ndonjë simbolike fizike apo shpirtërore ti përballojnë të këqijat të cilat mund të vijnë, më saktë nga mësyshi, magjia, e bomja etj. Dhe për të kaluar këto sfida, në disa raste është dashur të bëhen edhe sakrificat të ndryshme, të cilët kanë ndodhur si në individualitetin e femrës por dhe te meshkujt.

Për shembull tek ceremonit e dasmës, një ritë i veçantë është riti i kanagjegjit ku vajza e fejuar për të bërë nuse duhet të lyhet me këna nëpër disa pjesë të trupit në mënyrë që të mbrohet nga mësyshi. Edhe dhëndëri ka një formë sfidash të cilat kanë ardhë në kohën tonë duke u zbehur dhe janë bërë për argëtim, si riti i rruajtjes së dhëndërit, riti i natës së gjerdekut, riti i thirrjes te vjehri apo babgjyshi në petulla të cilat në vetevete janë ndërlidhje sociale por që përmbajnë plotë metafora, simbolika dhe sarkazma që lidhen me dhëndërin. Pikërisht këto ceremoni do të trajtojmë në tematikën tonë.

*Fjalët kyçe:* rite, dasma, dhëndëri, rruajtja, petulla.

### Dhëndëri si subjekt rituali

Ndër ceremonitë kryesore që i paraprijnë dasmës apo pritjes së nuses është rituali i rruajtjes së dhëndrit. Në fakt, ky rit është një nga segmentet e fazës së kalimit nga njëri në tjetrin, një status i ri shoqëror, siç thekson A. Genep në veprën e tij.<sup>337</sup> Kjo për faktin se djali tani merr një status të ri në shoqëri, nga një djalë i ri pa shqetësime dhe pa përkushtim në njeri që është përgjegjës për krijimin e një familje të re dhe kujdesin për të. Sipas traditës, rëndësi ka përkushtimi i burrit ndaj shtëpisë, organizimi i jetës së re familjare, kujdesi ndaj gruas dhe pasardhësve.

I riu është një subjekt i ritualizuar në këtë fazë dhe kryen të gjitha ritet me të cilat hyn në botën e burrave të martuar. Tradicionalisht, për të arritur në këtë fazë kishte zakone dhe praktika të tjera që janë aktuale sot. Lodraxhinjt janë të parët që zgjojnë të gjithë ditën e dasmës.<sup>338</sup> Dhëndri del në oborr duke përshëndetur të pranishmit me jehonën e zërave ironikë që i drejtohen nga të pranishmit; ndërsa vajzat dhe gratë e familjes e sulmojnë duke e derdhur ose spërkatur me ujë. Posaçërisht për këtë zakon mbushen enët me ujë nga të katër anët, me shpresën që heroi i ditës, dhëndri, të mos gjejë rrugë për të shpëtuar.

<sup>337</sup> Arnold Van Genep, *Rites de passage*, Picard, 1909, Paris, f.45

<sup>338</sup> Nebi Dervishi, *Etnokultura e fushëgropës së Ohrit*, Çabej, Tetovë, 2005, f.320



**Foto 1.** Materiale për ruajtjen e dhëndërrit, Strugë. 2018.

Simbolika e këtij zakoni është aktualisht e papërcaktuar. Ndoshta mund të lidhet me teorinë e A. Genep për kalimin në fazën tjetër që djali dëshiron ose përpiket ta "shmang". Pas ceremonisë së ujit, festa fillon në oborr, me muzikë dhe këngë nga një grup vajzash, të cilat këndojnë këngë të veçanta për ceremoninë e radhës, ruajtjen e dhëndërrit. Pasi ulet në një karrige, gjithmonë në oborr, para tij mbahet një peshqir i gjerë nën mjekër. Peshqiri zakonisht mbahet nga dy fëmijë, për të mbledhur të gjitha qimet nga mjekra, duke mbrojtur kështu dhëndrin nga veprimet e mundshme negative magjike. Një i afërm i familjes, duke marrë rolin e berberit, ia lan fytyrën me sapun dhëndërrit dhe më pas i rruan mjekrën.<sup>339</sup>



**Foto 2.** Rituali i ruajtjes së dhëndërrit, Strugë, 2018.

Në Strugë dhëndri rruhet zakonisht nga daja, xhaxhai ose ndonjë i afërm tjetër. Megjithatë, ky akt shoqërohet me muzikë. Është traditë që pas ruajtjes, dhëndri të japë bakshish muzikantëve dhe të kërcejë me babanë, nënën dhe të afërmit e tjerë.<sup>340</sup> Të rinjve që ndihmojnë

<sup>339</sup> Bexhet Asani, *Lirika popullore shqiptare në Maqedoni*, ITSHKSH, Shkup, 2017, f.86

<sup>340</sup> Petrit Fetahu, *Studime folklorike dibrane*, Dibër, 2004, f. 64

kur rruhet dhëndri u jepet një peshqir. Sapuni me të cilin rruhet dhëndri i përket atij që e ka kryer këtë punë.

Peshqiri me të cilin fshihet dhëndri, së bashku me qimet në të, mbështillet në mënyrë që të vendoset dhe të mbahet në një vend të fshehtë dhe të sigurt për t'u mbrojtur nga shpirtrat e këqij dhe ndikimet e tjera të këqija. Pra gjatë këtij akti ritualesk nuk ishte e preferuar që qimet të bien në tokë, anadaj që të mos ndodh kjo përkujdesej ndonjë e afërme. Në Derevn I thon kulaçtorja. Ajo e mbante afër dhëndërrit një maram në dorë në të ciliën binin qimet. Kulaçtorja gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti ritualesk nuk ishte e preferueshme të fliste me dike. Ajo pas përfundimit, i merrte qimet e grumbulluara në maramë dhe i hudhte në ndonjë vijë uji me qëlli që edhe shëndeti ti ecte dhëndërrit si uji.<sup>341</sup>

Pas rruajtjes së dhëndrit, zakonisht shkrehet një armë dhe luhen lojëra. Pas ceremonisë së rruajtjes së dhëndrit, të gjithë të ftuarve u shërbehet dreka. Nëpërmjet këngëve që këndohen me këtë rast, zgjohen kujtimet e ditëve të beqarisë, këndohet për veshjet që ka veshur deri atëherë, sepse pasi bëhet i martuar, edhe rrobat që vesh i ndryshojnë, zbukurohen, bëhen më shumë serioz dhe hyn në një fazë të re nga jeta e tij si dhëndër, e më pas si burrë dhe prind i martuar.

*Për këtë rast këndohen këngët:*

*“Çdo ditë nuk do të zbukurohesh si dhëndër/  
e s'të këndojnë me dajre/ dhe do të kesh halle.”<sup>342</sup>*

Riti i rruajtjes së dhëndrit është një rit gjithëpërfshirës që kryhet në një atmosferë të veçantë, ku para se berberi të fillojë punën e tij ose lavdërohet ose përbuzet. Nëpërmjet këngës jo vetëm shënohet fillimi i ritualit, por “lavdërohet” apo “fyhet” puna e berberit.

*"O berber e ke zanat  
E lae dhëndërrin tre sahat  
O berber, berber i vjetër  
Dorëzoju, që të marrim një tjetër.”<sup>343</sup>*

Por në kuadër të aplikimit të rimit shprehet edhe dëshira e të afërmeve të dhëndrit për të qenë sa më të bukur dhe të pashëm.

*O berber të kam të lutur  
të ma bajsh o dhanrin e bukur  
o berber l'u theftë kama  
ma baj dhanrin o allafrëng<sup>344</sup>*

Kënga që vijon më poshtë është ajo që mbart një barrë të rëndë emocionale:

*Hajde ta lidhim besën- o  
me nje fije kashtë /  
a ta duash nanën – sikur e ke dashtë  
Sa ta marr lulien mrenda  
nana n'derë e jashtë  
Nana n'derë e jashtë moj*

<sup>341</sup> Izaim Murtezani, *Rite dhe praktika magjike të ciklit jetësor*, Logos 5, Shkup 2008, f.114.

<sup>342</sup> Nuhi Vinca, *Lirika popullore shqiptare në regjionin e Strugës*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1992, f.89

<sup>343</sup> Edibe Selimi Osmani, *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe Gostivarit*, Shkup, 1993, f.9

<sup>344</sup> Petrit Fetahu, *Studime folklorike dibrane*, Ohër 2004, f.60

*ta mbulojmë me kashtë.*<sup>345</sup>

Në momentin që kjo këngë këndohet, ndikimi tek publiku është elektrizues dhe shkakton një reagim emocional. Më pas emocionet arrijnë kulmin, dhe shoqërohen me lot nga të pranishmit, njerëzit më të afërt me dhëndrin. Ky është momenti më emocionues për dhëndrin nga kjo fazë e dasmës. Vetë dhëndri paraqitet në poezi si një “objekt” admirimi në sytë e të ftuarve, por ka edhe një kuptim tjetër. Të bëhesh dhëndër shkakton njëfarë “smire” tek bashkëmoshatarët e djalit, të cilët do të donin të ishin në vendin e tij dhe të prisnin dasmën e tyre. Këtë “zili” e zbulon edhe teksti i këngës:

*Kur të bahesh dhandër – o  
dil në krye t’shallës  
prej merakut po na pjasin”  
djemntë e mëhallës.  
Kur të bahesh dhandër – o  
dil në breg te lumit  
prej merakut po na plasim, cucat e katunit.*<sup>346</sup>

Por nuk mund të lihej mënjanë as kostumi i tij, sepse kostumi i dhëndrit shënon hapin e parë të hyrjes së tij në jetën serioze bashkëshortore.

*“Dil dhëndër, mos u turpëro /  
në qoshe të presin treqind veta.”*<sup>347</sup>

Kënga si shoqëruese e veprimit ka ndikim të ardhshëm te pjesëmarrësit në rit, drejton veprimin, jep drejtimin e ngjarjeve. Pas rruajtjes, dhëndri është gati të luajë me të afërmit e tij. Për shembull:

*Hajde halla e madhe  
Hajde hidhe vallen moj halla e madhe  
Sa të paska hije  
Si bakllava hiç pa zije*<sup>348</sup>.

Roli drejtues i këngës nuk përfundon vetëm me dhënien e shumëdimensionalitetit të veprimit, por vazhdon të drejtojë veprimin.

*“Lëre tabakanë /  
ngrije shallin tonë.*

"Kënga nuk mund të “gabojë”, ajo fton hallat e babait të dhëndrit sipas moshës. Askush tjetër nuk mund të fillojë të luajë përveç hallës më të vjetër. Pasi mbarojnë udhëzimet nga kënga dhe të gjithë janë në valle, vlerësimi bëhet përmes këngës. Në këtë kuptim, analizat folklorike tregojnë se kënga e dasmës ngjan më shumë me një operetë që drejtohet dhe shoqërohet me veprime dhe shqetësim për protagonistët e ceremonisë.

<sup>345</sup> Informator: N. Abedini, 54 vjeçare, amvise, Strugë, 2020.

<sup>346</sup> Informator: M. Shemshedini, amvise, 46 vjeçare, Koroshishtë, Strugë, 2020. .

<sup>347</sup> Petrit Fetahu, *Lirika popullore dibrane*, Tetovë 2003, f.85.

<sup>348</sup> Po aty, f.124.

<sup>349</sup> Po aty, f.125.

Duke qenë se dasmat janë një grumbullim relativisht i madh njerëzish, fokusi më i madh i tyre është te nusja dhe dhëndri, ndaj sipas psikologjisë popullore, edhe mundësia për t'i dëmtuar ata është më e madhe. Ndryshe nga rendi ideal dhe tradicionalisht i vendosur, në shumë raste, veçanërisht në kohët moderne, gjërat mund të realizohen në një mënyrë tjetër. Meqenëse nusja ime ishte nga Shkupi, dhe krushqit e Strugës duhej të largoheshin herët në mëngjes për ta marrë nusen, e kuptuam se nuk do të ishte e mundur të organizohej rruajtja rituale për mua.

Nëna ime, nuk deshti ta anashkaloi këtë rit të rëndësishëm, sepse i dukej sikur unë jam i pa njeri dhe sugjeroi që një natë para se të shkonin ta merrnin nusen, të organizohej një natë e veçantë që të përfshinte ritin e rruajtjes së dhëndrit. Pra, riti i rruajtjes sime u organizua me të gjitha zakonet, me muzikë dhe me shumë të ftuar, të ftuar për këtë ngjarje, vetëm një ditë para kohës së caktuar ritualisht.<sup>350</sup> Kështu dhe te unë ndodhën të njëjtët rite sikurse në dasma ky rit organizohet para se të shkojnë ta marrin nusen, më saktësisht pas drekës që i bie diku nga ora 1.30 deri 2.00.

Rreth qafës me mbështollënn një peshqir të madh në të cilin duhet të bien mbetjet e mjekrës sime, apo formalisht të themi se unë e kasha pararregulluar mjekrën dhe berberi vetëm e mblodhi shkumbën që u bë me pjesën e pasme të zhiletës. Gjatë rruajtjes, të gjithë dasmorët më dhuruan para, nga 500 denarë e më shumë, varësisht nga afërsia familjare dhe farefisnia. Pas përfundimit të ceremonisë, çarçafin së bashku me paratë i mori nëna, ndërsa uji i mbetur në legen u hodh në trëndafil me qëllimin për të pasur një jetë të shëndetshme. Paratë janë të dhëndrit. Kurse berberit i dhanë bakshish apo dhuratë një këmishë dhe një peshqir. Të afërmëve të tjerë që mbajtën çarçafin me duar u dhanë një peshqir. Me këtë rast dasmorët kënduan duke rrahur dajre:

*Llokumi sheqerit osht i ombël o,  
Daja kët Riniun e bon dhondër o,  
Mos ke gajle more nëjp  
do tbëj daja presetnëjk,  
Mos ke gajle more bir,  
do tboj daja si vezir,  
mos ki gajle more vlla  
do tboj motra si aga.<sup>351</sup>*

Pas përfundimit të kësaj ceremonie, fillova të kërcejë me të gjithë të afërmit e mi, fillimisht me burrat, e më pas me tezet, hallat dhe kushërinjtë e tjerë, të cilët udhëheqin vallen,.

### **Ftesë e dhëndrit tek babai nuses, “Dita e petullave”**

Një zakon i vjetër që vazhdon ende dhe tregon mirëqenien e miqësisë (krushqisë) është vizita e parë e dhëndrit në familjen e nuses. Në disa vende ky rit quhet vizita tek gjyshi (tek babgjyshi), kurse në Strugë njihet si petullat e dëndërrit. Në rajonin e Shkupit dhe Pollog thonë "darkë te babgjyshi". Kjo ngjarje nuk përmban shumë rituale. Zakonisht dhëndëri te babgjyshi shkon një javë pas dasmës. Ai shkonte kur nusen e merrnin nga shtëpia e babait pas vizitës së saj në familjen e babait. Dhëndri shkonte me të afërmit e tij, me shtatë ose nëntë burra, ndërsa nusen e shoqëronin 5 deri në 7 gra, kështu që numri duhej të ishte tek.<sup>352</sup> Pas drekës ose darkës, në Strugë dhe rrethinë, dhëndri me një të afërm të nuses shkojnë në dhomën e grave dhe shpërndajnë dhurata ose peshqeshe mvarësisht sipas gjendjes familjare dhe moshës së mikeshave, poashtu u japin para fëmijëve.

<sup>350</sup> Involvim direkt në dasëm si pjesmarrës.

<sup>351</sup> Përjetim personal

<sup>352</sup> Informator: Q.Useini, 64 vjeçe, amvise, Strugë, 2021

E gjithë ngjarja ka një kuptim simbolik dhe figurative dhe zhvillohet në mënyrë të tërthort. Dhëndri thirret për të prerë dru, i shoqëruar nga i afërmi i tij dhe një i afërm i nuses. Por, në vend që ta marrin dhëndrin për të mbajtur një thes me dru, e marrin për “tja marrë dorën nënës së nuses” apo ta vendojnë te balli në formë respekti (vjehrrës, gjyshes).<sup>353</sup> Daja i dhëndrit i jepte para kujtdo mikeshë që e përshëndeste dhëndërrin. Më së shumti i jep vjehrrës apo gjyshes. Gjyshja i jep dhëndrit një këmishë dhe pixhame të gjata dhe gjëra të tjera në varësi të gjendjes ekonomike. Pasi dhëndri është kthyer në odën e burrave, me shaka e pyesin: “Si je, je lodhur?” etj.

I përshëndet me temena me dorë të gjithë që e prisnin në dhomë dhe ulet në fund të dhomës paksa i zënë ngushtë. Pas një kohe, i zoti i shtëpisë, sipas zakonit, i thotë tri herë dhëndrit të ulet dhe të rehatohet, njësoj sikur të ishte në shtëpinë e tij. Pas servirjes së mishit, në tavolinë vendoseshin edhe petulla dhe dhëndri merrë petullën më të madhe, e cila është e etiketuar për të. Këto petulla ndryshe quhen petullat e dhëndërrit.<sup>354</sup>

Interesant është edhe zakoni i vendosjes së diçkaje që do të turpërojë dhëndrin në këpucët e dhëndrit me qëllim që kur t'i veshë të mos të ndihet mire dhe të shkaktohet situatë komike. Për shembull, i vendosin jashtëqitje pule, gjemba, mjaltë, ngjitës etj. Por për të mos e turpëruar dhëndrin, gjatë kthimit, të pranishmit ndërronin këpucët, kështu që dikush që ishte më mirë i vishte dhëndrit, zakonisht ishte kushëriri i tij. Ka raste kur nusja e tij i dhuron të gjithëve para vetëm që të mos ia bëjnë këtë gjë dhëndrit.

Më pëlqenin shumë këto lloj lojërash, ndaj kur më duhej të fusja ngjitës në këpucët e kunatit, motra më mashtronte pa para dhe kur ishim në shtëpinë e gjyshit të vëllait, i mësoja fëmijët e vegjël të fushin ngjitës te këpucët e vëllait tim apo kokrra misri. Kështu që kur veshi këpucët ishte një moment interesant, të gjithë qeshën. Kjo sir it lidhet dhe me ritet e kalimit, të teorisë së njohur të Arnold Van Genepit, të kalimit nga faza e djalërisë në të dhëndërrisë periudh e cila mbartë në vetvete plot sfida dhe peripeci, por që me kohë janë zbehur.<sup>355</sup>

Në Kumanovë dhe në rajone të tjera kjo ceremoni është ndryshe. Dy javë pas dasmës ndodhin vizita të ndërsjella mes dy familjeve, familjes së dhëndrit dhe familjes së nuses. Kjo vizitë, e para pas dasmës, quhet me emër të një lloj gourabi prej miellit të bardhë që quhet kolaçe, “shkojmë për tortë ose vijmë për tortë”, ndërsa të ftuarit pjesëmarrës quhen kaleçar. Me këtë rast nëna e dhëndrit përgatit pasta, ëmbëlsira, byrekë me mollë dhe ëmbëlsira të tjera.

Me kaleçarët (mysafirët) bashkohet edhe zonja e shtëpisë (nëna e dhëndrit, vjehrra). Me të mbërritur, të ftuarit në shtëpinë e prindërve (shtëpia e prindërve të nuses) priten ngrohtësisht në dhomat e përgatitura posaçërisht për këtë vizitë, të ndarë si zakonisht në dhomë për femra dhe për meshkuj. Ndërsa në njërin anë shpërndahen gourabit dhe ëmbëlsirat e tjera të përgatitura për të rriturit dhe fëmijët e familjes së dasmës, nga ana tjetër, në dhomat e miqve, të ftuarit shërbehen fillimisht me kafe. Pavarësisht se në cilën orë mbërrijnë të ftuarit, shërbehet dreka ose darka. Në përgjithësi, është traditë që mysafirët të sjellin dhurata të vogla për nikoqirin.<sup>356</sup>

## Përfundim

Pra siç thamë ritet që lidhen me dhëndrin janë po aq interesante sikurse dhe ritet që lidhen me nusen dhe janë më argëtuese. Edhe pse janë rite që kanë të bëjnë me fazën e kalimit nga një periudhë në tjetrën sipas teorisë së Van Genepit, janë rite që paraqesin sfidën e dhëndrit i cili duhet të pastrohet. Dikur për të arritur në këtë stad janë kaluar dhe më shumë sakrificat të cilat tashmë janë zbehur.

<sup>353</sup> Nje formë e respektit ndaj më të vjetërve me origjinë turke, ja merrë dorën dikujt dhe e afron te balli e pastaj te mjekrra, e quajtur temena.

<sup>354</sup> A.Meta, 45 vjec, Ohër, punëtor, 2020.

<sup>355</sup> Arnold Van Genep, *Rites de passage*, Picard, 1909, Paris, f.45

<sup>356</sup> Informator: F.Asani, Kumanovë, amvise, 2021.

Janë të pranishme dhe këngët popullore të cilat ende fatmirësisht mbahen mend dhe e tërheqin secilin në valle si subjekte të rituaëizuar në këtë mori të gjerë veprimesh ritualeske. Me interes është dhe ballafaqimi për here të pare me familjen e nuses apo më saktë në ditën e petullave ku dhëndrit i bëhen disa rrengje me qëllim që ai ti kaloj disa sfida për tu bërë më i pjekur. Kjo tregon aftësin e ritit që ende ta mbaj të gjallë traditën popullore vendore.

## Referencat

- [1]. Arnold Van Genep, *Rites de passage*, Picard, 1909, Paris.
- [2]. Petrit Fetahu, *Lirika popullore dibrane*, Tetove 2003.
- [3]. Petrit Fetahu, *Studime folklorike dibrane*, Dibër, 2004.
- [4]. Nuhi Vinca, *Lirika popullore shqiptare në regjionin e Strugës*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1992.
- [5]. Edibe Selimi Osmani, *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe Gostivarit*, Shkup, 1993.
- [6]. Nebi Dervishi, *Etnokultura e fushëgropës së Ohrit*, Çabej, Tetovë, 2005.
- [7]. Izaim Murtezani, *Rite dhe praktika magjike të ciklit jetësor*, Logos 5, Shkup 2008.
- [8]. Bexhet Asani, *Lirika popullore shqiptare në Maqedoni*, ITSHKSH, Shkup, 2017.